

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-351/2023	Data: Datum: 27.04.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 15.02.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: “DEZINFEKTIM, DEZINSEKTIM, DHE DERATIZIM NË INSTITUCIONET KOMUNALE”, me numër të jashtëm prokurimi 633-23-2877-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-017-221, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: “DEZINFEKTIM, DEZINSEKTIM, DHE DERATIZIM NË INSTITUCIONET KOMUNALE”, me numër të jashtëm prokurimi 633-23-2877-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-017-221, dhe në komision caktohen

- 1.1** **Brahim Hetemaj**, Udh.sek. për shëndetësi, Kryesues i Komisionit,
- 1.2** **Mimoza Kabashi**, Drejtor në SHMU 'Martin Camaj' , anëtar dhe
- 1.3** **Mirëjeta Beqiraj**, Drejtor në qerdhën “Lulet e Jetës”, anëtar.

2. Komisioni i cetur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: “DEZINFEKTIM, DEZINSEKTIM, DHE DERATIZIM NË INSTITUCIONET KOMUNALE”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t'i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t'iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shëndetësi.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Administrat dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-350/2023	Data: Datum: 26.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen e Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), Statutin e komunës 01.Nr.62/2010 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe bazuar në kërkesën e Bajram Maxhunit-AQH, shqyrtoj kërkesën 06Nr.20/2023 të datës 26.04.2023 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Planit të Veprimit për Kujdesin Primar Shëndetësor 2024-2028, nxjerr:

V E N D I M

1. **THEMELOHET:** Grupi Punues për hartimin e Planit të Veprimit për Kujdesin Primar Shëndetësor 2024-2028 dhe në grupin punues caktohen:

- 1.1. **Dr. Tahir Kaliqani**, Kryesues i Grupit Punues, QKMF,
- 1.2. **Mexhide Imeraj**, anëtare, QKMF,
- 1.3. **Sevdije Shabanaj**, anëtare, QKMF,
- 1.4. **Arlinda Demaj**, anëtare, QKMF,
- 1.5. **Kastriot Idrizaj**, anëtar, QKMF,
- 1.6. **Marigona Bytyqi**, anëtare, QKMF,
- 1.7. **Jozef Frrokaj**, anëtar, QPS.

2. Grupi punues i lartcekur obligohet që të hartoj Planin e Veprimit për Kujdesin Primar Shëndetësor 2024-2028 në bashkëpunim me projektin e AQH-së; do të njoftoj Kryetarin me ecurinë e punës për hartimin e Planit të cekur në pikën 1 të këtij Vendimi dhe pas përfundimit një kopje të PVKPSH do t'ia dorëzojë Kryetarit si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe përgjegjësit tjera që janë në natyrën e këtij Grupi Punues.

3. Të gjitha punët juridike-administrative për nevoja të Grupit Punues, do t'i kryej: Drejtoria për Shëndetësi.

3. Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Grupi Punues.

4. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Grupit Punues,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-349/023	Data: Datum: 25.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim shqyrtoi kërkesën 10 Nr.553-15228 të datës 19.04.2023 të parashtruar nga Senada Luković nga fsh. Kashicë për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me kërkesën 10Nr.20/2023 të datës 19.04.2023 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 10 Nr.553-15228 e datës 19.04.2023 e parashtruar nga Senada Luković, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00€(treqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Senada Luković, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Senada Luković, ka parashtruar kërkesën 10 Nr.553-15228 të datës 19.04.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Senada është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **300.00€(treqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Senada Luković në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Senada Luković,
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-348/023	Data: Datum: 25.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim shqyrtoi kërkesën 10 Nr.553-10793 të datës 16.03.2023 të parashtruar nga Hajrije Mujaj nga fsh. Serbobran për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim, dhe me kërkesën 10Nr.20/2023 të datës 19.04.2023 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 10 Nr.553-10793 e datës 16.03.2023 e parashtruar nga Hajrije Mujaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **250.00€(dyqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Hajrije Mujaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiave.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Hajrije Mujaj, ka parashtruar kërkesën 10 Nr.553-10793 të datës 16.03.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Hajrija është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

E përmendura është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **250.00€(dyqind e pesëdhjetë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Hajrije Mujaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Hajrije Mujaj,
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-347/023	Data: Datum: 25.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, shqyrtoi kërkesën 10 Nr.553-13029 të datës 03.04.2023 të parashtruar nga Jasmin Tahirović nga fsh. Bajë për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e vajzës Nejla Tahirović, dhe me kërkesën 10Nr.20/2023 të datës 19.04.2023 i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 10 Nr.553-13029 e datës 03.04.2023 e parashtruar nga Jasmin Tahirović, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e vajzës Nejla Tahirović, dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00€(treqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Jasmin Tahirović, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësiive.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Jasmin Tahirović, ka parashtruar kërkesën 10 Nr.553-13029 të datës 03.04.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërimin e vajzës.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Nejla Tahirović është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërimin e vajzës Nejla Tahirović, dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **300.00€(treqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Jasmin Tahirović në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Jasmin Tahirović,
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-346/023	Data: Datum: 25.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, shqyrtoi kërkesën 10 Nr.553-11651 të datës 22.03.2023 të parashtruar nga Skender Smakaj nga fsh. Carallukë për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes Kada Smakaj, dhe me kërkesën 10Nr.20/2023 të datës 19.04.2023, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 10Nr.553-11651 e datës 22.03.2023 e parashtruar nga Skender Smakaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes Kada Smakaj, dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **200.00€(dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e Skender Smakaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim.
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Skender Smakaj, ka parashtruar kërkesën 10 Nr.553-11651 të datës 22.03.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se Kada Smakaj, është e sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike, pensionist dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërimin e bashkëshortes dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrasht vetëm në shumë prej **200.00€(dyqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim është përcaktuar edhe pozicioni i subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrasht dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Skender Smakaj në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u theksua u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Skender Smakaj,
- Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-345/2023	Data: Datum: 25.04.2023	

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në bazë të nenit 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe në bazë të nenit 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, shqyrtoi kërkesën Nr.09-320-15151 të datës 18.04.2023 të parashtruar nga Agim Maxharraj, nga fsh Vrellë, Komuna Istogut, për kompensimin e dëmit të shkaktuar-ngordhja e dhisë qumështorë si pasojë e sëmundjes dhe me kërkesën 09Nr.54/2023 të datës 19.04.2023, i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.09-320-15151 e datës 18.04.2023 e parashtruar nga Agim Maxharraj për përkrahje financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga sëmundja dhe si pasojë ngordhja e dhisë qumështorë dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transvere nga programi buxhetor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Agim Maxharraj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.
4. Vendimi është përfundimtar.
- 5.

A r s y e t i m

Agim Maxharraj, ka parashtruar kërkesën Nr.09-320-15151 të datës 18.04.2023 me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga sëmundja dhe si pasojë ngordhja e dhisë qumështorë.

Kryetari shqyrtoi propozimin e Komisionit për vlerësimin e dëmit për ngordhjen e dhisë qumështorë dhe të njëjten e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Komisioni pas shqyrtimit të procesverbalit të Inspektorit të Veterinës i cili ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka vlerësuar dëmin ngordhja e dhisë qumështorë nga sëmundja dhe bazuar në mundësitë buxhetore të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi, përkrahet në shumë prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)**.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake ti blejë dhinë, e që me qumështin e saj e ka ushqyer familjen.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Agim Maxharraj,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ

[Signature]

Kryetari i Komunës
 z.Illir FERAT

[Signature]

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-344/2023	Data: Datum: 25.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-15168, të datës 19.04.2023, të parashtruar nga z.Ramiz Dreshaj, nga f.sh.Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e prindit të tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-15168, të datës 19.04.2023, e parashtruar nga z.Ramiz Dreshaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e nënes se tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore, dhe i lejohen 280 litra karburant, sipas raporteve mjekësore.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Ramiz Dreshaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Ramiz Dreshaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-15168, të datës 19.04.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i prindit të tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se: znj.Ajmane Dreshaj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi, do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Ramiz Dreshaj, Drejtoria për Shëndetësi, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqese e Sektorit Ligjor

Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- <u>343</u> /023	Data: Datum: <u>25</u> .04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nën 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-15740 të datës 25.04.2023, të parashtruar nga z.Xhevdet Sejdiu, nga fsh.Lubozhdë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-15740, e datës 25.04.2023, e parashtruar nga z.Xhevdet Sejdiu, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (pesëqindë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor, administrata në Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Xhevdet Sejdiu, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Xhevdet Sejdiu, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-15740, të datës 25.04.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Xhevdet Sejdiu është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **500.00€ (pesëqindë euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Xhevdet Sejdiu, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z.Xhevdet Sejdiu,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
Z.ILIR FERATI




	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		
Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	01Nr.Br.338/023	Data Datum: 24.04.2023	Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality

Kryetari i Komunës, në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë Nr.28/2008), nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010 dhe bazuar në nenin 8 paragrafi 3 dhe neni 9 të Rregullores MF 4/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, shqyrtoj kërkesën 09 Nr.55/2023 të datës 19.04.2023 të parashtruar nga Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi për ndërrimin e anëtarit të komisionit në pikën 3 të Vendimit 01 Nr1089/2022 të datës 08.12.2022, nxjerr:

V E N D I M

1.Ndërrohet anëtari i Komisionit në pikës 3 të Vendimit 01 Nr1089/2022 të datës 08.12.2022, pasi që anëtarit të komisionit Dardan Blakaj i ka përfunduar Kontrata e punës dhe në vend të tij caktohet Egzon Kabashi si anëtar i tretë i këtij Komisionit për pranimin, shpërndarjen e fidanëve dhe verifikimin e punëve në terren.

2. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni dhe Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi.

3. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

**Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ**



**Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI**




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-337/023	Data: Datum: 24.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008) në nenit 39 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 8/2019) dhe bazuar në nenin 59 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, shqyrtoi kërkesën me Nr.02-77/023 të datës 20.04.2023 të parashtruar nga NJMBNJ për themelimin e Komisionit ad-hoc të vlerësimit për ngritje (avancim) në detyrë, nxjerr:

V E N D I M

1. TEMELOHET: Komisioni ad-hoc i vlerësimit për ngritjen (avancim) në detyrë, për vlerësimin nëpërmjet testit me shkrim dhe intervistës me gojë të kandidatëve të cilët kanë konkurruar për pozitën: Menaxher i Personelit në kuadër të Zyrës së Kryetarit dhe komisioni themelohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. Zizë Bujupaj,** E emëruar-Menaxher i Personelit-NJMBNJ, Kryesuese e Komisionit;
- 1.2. Haki Ibrahimaj,** Drejtor i Qendrës për punë Sociale, anëtar dhe;
- 1.3. Rasim Mahmutović,** Udhëheqës i Sektorit për Komunitet dhe Kthim, anëtar;

Anëtar Rezervë:

- 1.1. Fjollë Berisha,** Zyrtare e Lartë e Personelit;
- 1.2. Brahim Hetamaj,** Udhëheqëse e Sektorit për Shëndetësi;
- 1.3. Enisa Ćorović,** Zyrtare për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komuniteteve.

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do ti kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij kujdeset Komisioni.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Zyrës Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-335/023	Data: Datum: 24.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) në nenin 68.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, shqyrtoi kërkesën se bashku me projekt-propozimin Nr.01-400-11142 të datës 20.03.2023 të parashtruar nga Masar Kabashi nga Gjukurkoci për përkrahje financiare dhe i propozoi Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-400-11142 e datës 20.03.2023, e parashtruar nga Masar Kabashi dhe i ndahen mjete financiare në shumë prej **500.00€ (treqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i Zyrës së Kryetarit, për realizimin e projektit: "Istogu Trial-Epojeja e Prillit".
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1. të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Masar Kabashit në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Zyra e Kryetarit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

Masar Kabashi, ka parashtruar kërkesën Nr.01-400-11142 të datës 20.03.2023, për përkrahje financiare për realizimin e projektit: "Istogu Trial-Epojeja e Prillit".

Kryetari shqyrtoi kërkesën e Masar Kabashit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Masar Kabashi ka kërkuar mjete financiare në shumë prej **5,720.00€**, por në mungesë të mjeteve financiare përkrahjet financiarisht në shumë prej **500.00€** për shkak të rëndësisë së realizimit të projektit propozimit të cekur me lartë.

Në plan programin buxhetor të Zyrës së Kryetarit është përcaktuar edhe pozicioni i subvencioneve dhe transfereve, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë momentale.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Masar Kabashit, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi..

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Masar Kabashi,
- Zyrtarit Financiar dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-334/2023	Data: Datum: 24.04.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), në nenin 40 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 24.04.2023, për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit për projektet: “GJENERATOR PËR NËVOJA TË SHËTËPISË PËR KOMUNITETE NË GURRAKOC DHE SHFMU MEHMET AKIF SHUSHICË”, me numër të jashtëm prokurimi 633-23-2868-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-018-121, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit për projektet: “GJENERATOR PËR NËVOJA TË SHËTËPISË PËR KOMUNITETE NË GURRAKOC DHE SHFMU MEHMET AKIF SHUSHICË”, me numër të jashtëm prokurimi 633-23-2868-1-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-018-121, dhe në komision caktohen

- 1.1** **Brahim Hetemaj**, Udh.sek. për shëndetësi, Kryesues i Komisionit,
- 1.2** **Januz Ahmetaj**, zv.drejtor në SHMT Mit’hat Frasheri në, anëtar dhe
- 1.3** **Isa Hoxhaj**, Zyrtar i lartë për Efëncë, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit “GJENERATOR PËR NËVOJA TË SHËTËPISË PËR KOMUNITETE NË GURRAKOC DHE SHFMU MEHMET AKIF SHUSHICË”, me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Anëtarët e komisionit vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin teknik të ofertës sipas nenit 40 paragrafi 40.3 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

5. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së dhe Rregullave të Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja.

6. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

7. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni, Prokurimi dhe Drejtoria për Shëndetësi.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Drejtorisë për Administratë dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-<u>333</u>/023	Data: Datum: <u>24</u> .04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/2008), bazuar në nenin 81 të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068, Ligjin Nr.05/L-092, bazuar në Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01 i miratuar me datën 01.02.2021 nga KRPP-ja, shqyrtoj kërkesën e Prokurimit të datës 21.04.2023, për caktimin e Menaxherit të kontratës dhe Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës për projektin: “Mirëmbajtja dhe Servisimi i Rentgen Aparatit”, nxjerr:

V E N D I M

1. **CAKTOHET:** Menaxheri i kontratës **z.Shaban Bajraktari**, teknik i Radiologjisë në QKMF, për projektin: “Mirëmbajtja dhe Servisimi i Rentgen Aparatit” me numër të jashtëm prokurimi 633-23-1697-2-2-1, dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-023-009-221, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës **CAKTOHET: z.Zenel Shatri**, Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi, të cilin projekt e ka fituar për ta realizuar operatori ekonomik “**LEDI MED**” SH.P.K nga Prishtina.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës obligohen që të bëjë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës duke zbatuar nenin 61 të Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik Nr.A01, si dhe Manualët për Përdorim të Modullit për Menaxhim të Kontratës.
3. Përgjegjësin për realizimin e projektit të lartcekur e merr: Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës.
4. Ky vendim hynë në fuqi ditën e nënshkrimit.
5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- **z.Shabab Bajraktari**, Menaxher i kontratës
- **z.Zenel Shatri**, Mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj. Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës-ZKA
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 330/023	Data: Datum: 18.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar ne nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), ne nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-5239 të datës 06.02.2023, të parashtruar nga z.Ahmet Zekaj, nga Istogu, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-5239, e datës 06.02.2023, e parashtruar nga z.Ahmet Zekaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **350.00€ (treqindë e pesdhjetë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor, administrata në Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Ahmet Zekaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Ahmet Zekaj, ka parashtruar kërkesën 01 Nr.553-5239, të datës 06.02.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Ahmet Zekaj është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **350.00€ (treqindë e pesdhjetë euro)**. Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Ahmet Zekaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z.Ahmet Zekaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ





 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- <u>323</u> /2023	Data: Datum: 18.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën Drejtorisë për Shëndetësi Nr.06-553-14371, të datës 12.04.2023, të parashtruar nga z.Mergim Zekaj, nga f.sh.Shushicë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për marrjen e dializës në Pejë, për prindin e tij, dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-14371 e datës, 12.04.2023 e parashtruar nga z.Mergim Zekaj, për përkrahje me karburant për dërgimin e prindit të tij për marrjen e dializës në Pejë dhe i lejohen 57 litra karburant për muaj .
2. Obligohet Zyrtari i Transportit që të pajisë z.Mergim Zekaj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Mergim Zekaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-14371, të datës 12.04.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i prindit të tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se z.Gjevat Zekaj, është i sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e dializës në Pejë. I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij në Pejë për marrjen e terapisë dializës mjekësore. Zyrtari i transportit do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejnë edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi. Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z.Mergim Zekaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
 znj.Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-328/023	Data: Datum: 18.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nën 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nën 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 01 Nr.553-12261 të datës 27.03.2023, të parashtruar nga z.Abaz Mavraj, nga f.sh Staradran, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

- MIRATOHET:** kërkesa 01 Nr.553-12261, e datës, 27.03.2023, e parashtruar nga z.Abaz Mavraj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00€ (treqindë euro)** nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor i administrata në Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Abaz Mavraj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Abaz Mavraj, ka parashtruar kërkesën 01 Nr.553-12261, të datës 27.03.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Abaz Mavraj është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapinë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **300.00€ (treqindë euro)**. Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e tij në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z.Abaz Mavraj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-327/023	Data: Datum: 18.04.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e datës 18.04.2023 të parashtruar nga Prokurimi për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: “Ndërtimi i transfer deponisë në Tyqep”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-2675-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-015-521, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: “Ndërtimi i transfer deponisë në Tyqep”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-2675-5-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-015-521 dhe në komision caktohen:

- 1.1 Naser Nimanaj,** Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, Kryesues i Komisionit;
- 1.2 Hekuran Rugova,** Arkitekt, anëtar dhe
- 1.3. Muhamet Demaj,** Koordinator teknik i Emergjencave, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit: “Ndërtimi i transfer deponisë në Tyqep” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësisht dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Prokurimi.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]

Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-326/023	Data: Datum: 14.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 22 paragrafi 8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019), shqyrtojë kërkesën Nr.01-016-14080 të datës 07.04.2023 të parashtruar nga z.Abedin Neziraj, Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitetit në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, për pezullimin e marrëdhënies së punës, nxjerri:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa Nr.01-016-14080 e datës 07.04.2023 e parashtruar nga z Abedin Neziraj, Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitetit në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim, për pezullimin e marrëdhënies së punës dhe i pezullohet marrëdhënia e punës nga data 07.04.2023 deri në përfundimin e mandatit Këshilltarit Politik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal .
- 2.** Obligohet Menaxheri i Personelit që z.Abedin Neziraj, pas përfundimit të emërimit Këshilltar Politik i Ministrit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal sipas Vendimit numër 02-257/28 të datës 07.04.2023, të kthejë në pozitën e Zyrtarit Publik si Zyrtar për Koordinimin e të Drejtave dhe Integrim të Komunitetit në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim.
- 3.** Obligohet Zyrtarja Financiare-përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime, që të dërgoj Vendimin tek Divizioni i Pagesave në Ministrinë e Financave për z.,Abedin Neziraj, të cilit i pezullohet marrëdhënia e punës sipas pikës 1 të këtij Vendimi dhe nga data 07.04.2023 në listën e pagave të jetë me zero.
- 4.** Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Zyrtarja Financiare-Përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime, Menaxheri i Personelit.
- 5.** Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- zAbedin Neziraj;
- Zyrtares Financiare-Përgjegjëse për Paga, Mëditje dhe Kompensime;
- Menaxherit të Personelit dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-325/2023	Data: Datum: 14.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01 Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtoria për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08Nr.120-13372 të datës 04.04.2023 të parashtruar nga Niman Çapkunaj nga Istogu, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e vajzës Edona Çapkunaj me shkresë të 08Nr.191/2023 të datës 06.04.2023 dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 08Nr.120-13372 e datës 04.04.2023, e parashtruar nga Niman Çapkunaj, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e vajzës Edona Çapkunaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencionë fondi burimore 21-përfitues individual P.I kodi ekonomik 22220-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
- 2.** Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Niman Çapkunaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- 3.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Niman Çapkunaj,
- Drejtoria për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-324/2023	Data: Datum: 14.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58. pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-13099 të datës 03.04.2023 të parashtruar nga Arjan Metaj nga f.sh Shushicë për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Zejniye Metaj me shkresë të 08Nr.190/2023 të datës 06.04.2023 dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.120-13099 e datës 03.04.2023, e parashtruar nga Arjan Metaj, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e nënës Zejniye Metaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione fondi burimore 21-përfitues individual P.I kodi ekonomik 22220-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
- 2.** Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Arjan Metaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
- 3.** Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
- 4.** Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Arjan Metaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-323/2023	Data: Datum: 14.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58, pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008) në nenin 46, 47 dhe 49 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe bazuar në Rregulloren për Mirëmbajtjen, Rregullimin dhe Ruajtjen e Varrezave 01Nr.68/2021 të miratuar me datë 29.06.2021, Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, shqyrtoi kërkesën 08 Nr.120-12926 të datës 31.03.2023 të parashtruar nga Yllka Mulaj nga f.sh Banjë, Komuna e Istogut për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Enver Mulaj me shkresë të 08Nr.189/2023 të datës 06.04.2023 dhe i propozon Kryetarit të nxjerrë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 08 Nr.120-12926 e datës 31.03.2023, e parashtruar nga Yllka Mulaj, për përkrahje financiare për shpenzimet e varrimit për vdekjen e babait Enver Mulaj dhe sipas Rregullores përkrahet me mjete financiare në shumë prej **200.00€ (dyqind euro)** nga kategoria ekonomike subvencione fondi burimore 21-përfitues individual P.I kodi ekonomik 22220-shpenzime të varrimit nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shërbime Publike.
2. Mjetet e përcaktuara, në pikën 1 të këtij Vendimi, do të transferohen në xhirollogarinë e Yllka Mulaj, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi.
3. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Drejtoria për Shërbime Publike.
4. Vendimi është përfundimtarë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Yllka Mulaj,
- Drejtorisë për Shërbime Publike dhe
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 321/2023	Data: Datum: 13.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-13606, të datës 05.04.2023, të parashtruar nga znj.Nebahate Zeqiraj, nga fsh.Prigodë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për marrjen e Radio-terapisë në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-13606, të datës 05.04.2023, e parashtruar nga znj.Nebahate Zeqiraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e saj në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore(radioterapisë), dhe i lejohen 250 litra karburant, për t'i mundësuar udhëtimin e saj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë znj.Nebahate Zeqiraj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejnë për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

znj.Nebahate Zeqiraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-13606, të datës 05.04.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurës dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se znj.Nebahate Zeqiraj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

E lartpërmendura nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e saj për në Prishtinë për marrjen e terapisë.

Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurën më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe në pajtim me procedurat që vlejnë edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: znj.Nebahate Zeqiraj, Drejtoria për Shëndetësi, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udh.sektorit ligjor
 Zekije Sutaj

[Signature]



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br.319 /2023	Data: Datum: 13.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-9342 të datës 06.03.2023, të parashtruar nga Ismet Rexhaj nga Cerrca, Komuna e Istogut dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për shërim, të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-9342 e datës 06.03.2023, e parashtruesit Ismet Rexhaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozimin e Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **150.00 € (një qind e pesëdhjete euro)**, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, kategoria ekonomike subvencione e transfere, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Ismet Rexhaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ismet Rexhaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-9342, me datë 06.03.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi propozimin e komisionit për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet së Ismeti është i sëmurë dhe ka nevojë për blerjen e terapisë për shërim, e cila është mjaftë e kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanke të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **150.00 € (një qind e pesëdhjete euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Ismet Rexhaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ismet Rexhaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije Sutaj,




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-318/023	Data: Datum: 12.04.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e datës 12.04.2023 të parashtruar nga Prokurimi për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: “Furnizimi me table sportive me LED në palestër të qytetit”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-2744-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-016-136, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: “Furnizimi me table sportive me LED në palestër të qytetit”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-2744-1-3-6 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-016-136 dhe në komision caktohen:

- 1.1 Faton Bytyçi,** Zyrtar për Administrimin e Teknologjisë Informative, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Qefser Ibrahimaj,** Zyrtare e lartë për trashëgimi kulturore dhe arkiv të qytetit, anëtar;
- 1.3. Faruk Shala,** Trajner KHF Istogu, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: “Furnizimi me table sportive me LED në palestër të qytetit” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Prokurimi.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PRESDENIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-317/023	Data: Datum: 12.04.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e datës 12.04.2023 të parashtruar nga Prokurimit për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: “Mirëmbajta e E-Kioskave”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-2200-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-011-221, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: “Mirëmbajta e E-Kioskave”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-2200-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-011-221 dhe në komision caktohen:

- 1.1. Berat Gjoci,** Zyrtar i Prokurimit², Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Agim Pacaj,** Zyrtar për Shërbim me Qytetar, anëtar dhe
- 1.3. Faton Bujupi,** Udhëheqës i Sektorit për Gjendje Civile, anëtar.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuar në dosjen e tenderit: “Mirëmbajta e E-Kioskave” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës së Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Prokurimi.

7. Vendimi është përfundimtarë.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-316/023	Data: Datum: 12.04.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe në nenin 69 paragrafi 4 i Statutit të komunës 01.Nr.62/2020 i miratuar me datë 30.11.2010, shqyrtoj kërkesën 12 Nr.45/2023 të datës 07.04.2023 të parashtruar nga Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport, për themelim të komisionit për verifikimin e punimeve për projektin: “Ndërtimi i qendrës rinore në fshatin Uçë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-11832-5-2-1/C673 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-013-521, nxjerr:

V E N D I M

1. THEMELOHET: Komisioni për verifikimin e punimeve për projektin: “Ndërtimi i qendrës rinore në fshatin Uçë”, me numër të jashtëm prokurimi 633-022-11832-5-2-1/C673 dhe me numër të brendshëm prokurimi 633-022-013-521, të cilin projekt e ka realizuar operatori “**AXIS G.C.W**” **SH.P.K** nga Fushë Kosova dhe në komision caktohen:

- 1.1. Hekuran Rugova**, Arkitekt, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Elfete Blakaj**, Udhëheqëse e Sektorit për Mbrojtje të Mjedisit, anëtare dhe
- 1.3. Naser Nimanaj**, Zyrtar i Lartë për Infrastrukturë Rrugore, anëtar.

2. Komisioni do të bëjë kontrollimin e tërë dokumentacionit dhe realizimin teknik të projektit të cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, sipas projektit detal ekzekutiv; do të njoftojë kryerësin e punëve me të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet sa i përket kryerjes së punimeve; do të njoftoj Menaxherin e kontratës dhe Mbikëqyrësin e drejtpërdrejtë të Menaxherit të kontratës; do të hartojë procesverbalin gjatë verifikimit të punimeve në terren; do të hartoj raportin e pranimit teknik të projektit; do të njoftojë Kryetarin lidhur me realizimin punimeve për projektin e lartcekur; si dhe do t'i kryejë punët dhe detyrat tjera që kanë të bëjnë me natyrën e këtij komisioni.

3. Përgjegjësin për verifikimin e punëve për projektin e lartcekur e merr Komisioni, Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të kontratës.

4. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Komisioni, Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe Prokurimi.

5. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimi,
- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport,
- AXIS G.C.W-SHPK operator
- Arkivi i zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



Kryetari Komunës
z.Illir FERATI

Illir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-315/023	Data: Datum: 08.04.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008) dhe bazuar në shkresën zyrtare të datës 07.04.2023 nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal për ri konfirmimin e Vendimit për caktim të Koordinatorit të Sistemit Menaxhimit Përformancës Komunale (SMPK) dhe zyrtarëve raportues për fushat të SMPK-së, për shfuqizimin e Vendimit 01Nr.455/2020 të datës 10.09.2020, nxjerr:

V E N D I M

1. SHFUQIZOHET: Vendimi 01 Nr.455/2020 i datës 10.09.2020, dhe caktohet Koordinatori i SMPK-së dhe zyrtarët përgjegjës-raportues për fushat e SMPK-së, janë si me poshtë:

- 1.1. Faton Bytyçi,** Koordinator i SMPK-së;
- 1.2. Ardon Arifaj dhe Jeta Balaj,** Fusha:2-Transparenca komunale;
- 1.3. Jehona Arifaj,** Fusha:1-Shërbimet Publike Administrative;
- 1.4. Vjosa Hysenaj,** Fusha:2-Transparenca komunale, Fusha:3-Përgjegjshmëria Komunale, Fusha:16-Përfaqësimi Gjinor;
- 1.5. Zekije Sutaj,** Fusha:3-Përgjegjshmëria Komunale
- 1.6. Qefsere Ibrahimaj,** Fusha:5-Kulturë Rini dhe Sport;
- 1.7. Arlinda Kurtaj dhe Vlora Gjoci,** Fusha:16-Përfaqësimi gjinor;
- 1.8. Naser Nimanaj,** Fusha 9-Infrastruktura rrugore, Fusha 10-Transporti Publik, Fusha 11-Parkingjet Publike;
- 1.9. Naser Gjocaj,** Fusha 3-Përgjegjshmëria komunale, Fusha 12-Uji i pijshëm, Fusha 13-kanalizimi, Fusha 14-Menaxhimi i mbeturinave;
- 1.10. Xhevdet Zekaj,** Fusha 17-Arsimi para universitar;
- 1.11. Rrustem Gashi,** Fusha 7-Planifikimi hapësinor komunal;
- 1.12. Elfete Blakaj,** Fusha 8-Hapsirat publike, Fusha 15-Mbrojtja e mjedisit;
- 1.13. Skender Hasngjekaj,** Fusha 6-Menaxhimi i fatkeqësive, Fusha 4-Barazia në punësim;
- 1.14. Arta Fetahu,** Fusha 19-Zhvillimi ekonomik lokal;
- 1.15. Fjollë Berisha,** Fusha 4-Barazia në punësim, Fusha:16-Përfaqësimi gjinor;
- 1.16. Myrvete Verbaj,** Fusha 4-Shërbime sociale dhe familjare;
- 1.17. Arlinda Demaj,** Fusha 18-Kujdesi primar Shëndetësor;

2. Koordinator i SMPK-së koordinon punën e përgjithshme në komunë për administrimin e sistemit për matjen e përformancës komunale dhe udhëheqë punën në procesin e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të të dhënave të SMPK-së.

3. Zyrtarët përgjegjës-raportues për fushat e SMPK-së, do të hartojnë planin për mbledhje, verifikimin dhe raportimin e të dhënave për fushat përkatëse të ngarkuar sipas kërkesave të Koordinatorit të SMPK-së, kujdeset që para futjes së të dhënave në sistem të verifikoj saktësinë e të dhënave duke u bazuar vetëm në dokumente zyrtare të miratuara nga organet komunale dhe të protokolluara.

4. Të gjitha punët teknike administrative për nevojat e komisionit do ti kryej Drejtoria për Administratë Komunale.

5. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për realizimin e tij do të kujdeset: Komisioni, dhe Drejtoria për Administratë Komunale.

8. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Drejtorisë për Administratë Komunale,
- Ministrit të Administrimit Pushtetit Lokal dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

[Signature]



Kryetari Komunës
z. Ilir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- <u>314</u> /023	Data: Datum: 06.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-6975 të datës 16.02.2023, të parashtruar nga z.Faik Berishaj, nga fsh.Dobrushë, Komuna e Istogut për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij, dhe i propozon Kryetarit të nxjerr:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-6975, e datës 16.02.2023, e parashtruar nga z.Faik Berishaj, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij dhe me propozim të Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej 300.00€ (treqindë euro) nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nga programi buxhetor, administrata në Shëndetësi, si ndihmë momentale për shërim.
2. Mjetet e cekura do të transferohen në xhirollogarinë e z.Faik Berishaj, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësisë.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi
4. Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

z.Faik Berishaj, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-6975, të datës 16.02.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërimin e tij. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet se z.Faik Berishaj është i sëmurë dhe si pasojë e kësaj ka nevojë për blerjen e terapisë të cilat janë mjaftë të kushtueshme. I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave dhe kjo i pamundëson që me mjete vetanake të bëjë blerjen e terapisë për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej 300.00€ (treqindë euro). Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi, është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim. Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e z.Faik Berishaj, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me menaxhimin e financave publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z.Faik Berishaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-311/2023	Data: Datum: 04.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për shqyrtimin e kërkesave të qytetarëve për përkrahje financiare në shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-13010 të datës 03.04.2023, të parashtruar nga z.Zeqir Blakaj nga f.sh Vrellë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për marrjes e terapisë në QKUK-Klinika e Onkologjisë në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. MIRATOHET: kërkesa Nr.06-553-10310, e datës 03.04.2023 e parashtruar nga z.Zeqir Blakaj për përkrahje me karburant, për marrjen e radioterapisë në QKUK- Klinika e Onkologjisë në Prishtinë dhe i lejohen 100 litra karburant për kompenzimin e transportit.
2. Obligohet Zyrtari i autoparkut që z.Zeqir Blakaj të pajisë me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit si në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Zyrtari i Transportit.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Zeqir Blakaj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-13010 e datës 03.04.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i tij në QKUK- Klinika e Onkologjisë në Prishtinë për marrjen e terapisë.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se z.Zeqir Blakaj është i sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e terapisë në QKUK- Klinika e Onkologjisë në Prishtinë.

I lartpërmenduri është në gjendjen ekonomiko sociale jo të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij në Prishtinë.

Zyrtari i transportit do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- z.Zeqir Blakaj,
- Drejtorisë për Shëndetësi,
- Zyrtarit të Transportit dhe
- Arkivin e zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ

Zekije SUTAJ

Kryetari Komunës
z.Illir FERATI

Illir FERATI

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01- 310/2023	Data: Datum: 04.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-12631, të datës 30.03.2023, të parashtruar nga z.Fatmir Hajzeraj nga fsh.Uçë, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes se tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-12631, të datës 30.03.2023 e parashtruar nga z.Fatmir Hajzeraj, për përkrahje me karburant për dërgimin e bashkëshortes se tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore(kimioterapisë), dhe i lejohen 100 litra karburant.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Fatmir Hajzeraj, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Fatmir Hajzeraj, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-12631, të datës 30.03.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i saj. Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se bashkëshortja, znj.Mihanë Hajzeraj, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e tij për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi. Për sa u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimi të këtij Vendimi.

Vendimi i dergohet:

- z.Fatmir Hajzeraj,
- Shefi i autoparkut,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivit të Zyrës së Kryetarit

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSIEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-309/2023	Data: Datum: 04.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47. dhe 48. të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016) dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014, Drejtoria për Shëndetësi, shqyrtoi kërkesën Nr.06-553-11485, të datës 21.03.2023, të parashtruar nga z.Shemsedin Berisha nga fsh.Saradran, Komuna e Istogut, për përkrahje me karburant për dërgimin e vajzes se tij në QKUK në Prishtinë dhe i propozon Kryetarit të nxjerri:

V E N D I M

1. **MIRATOHET:** kërkesa Nr.06-553-11485, të datës, 21.03.2023, e parashtruar nga z.Shemsedin Berisha, për përkrahje me karburant për dërgimin e Vajzes se tij në QKUK - Prishtinë për marrjen e terapisë mjekësore, dhe i lejohen 240 litra karburant sipas raportit mjekësor, për (6) muaj.
2. Obligohet Shefi i autoparkut që të pajisë z.Shemsedin Berisha, me vërtetim për furnizim me karburant të automjetit, në sasinë e cekur në pikën 1. të këtij Vendimi, në pajtim me procedurat të cilat vlejné për furnizim me karburant të automjeteve zyrtare, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi.
3. Ky vendim hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të tij dhe për zbatimin e tij, do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi dhe Shefi i autoparkut.
4. Vendimi është përfundimtarë.

A r s y e t i m

z.Shemsedin Berisha, ka parashtruar kërkesën Nr.06-553-11485, të datës 21.03.2023, me të cilën ka kërkuar që t'i mundësohet furnizimi me karburant për automjetin më të cilin bëhet transportimi i vajzes se tij.

Kryetari shqyrtoi kërkesën e të përmendurit dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton. Nga kërkesa e parashtruar dhe raportet mjekësore shihet se: Vjona Berisha, është e sëmurë dhe i ndihmohet me karburant për mbushjen e veturës për dërgimin e saj për marrjen e terapisë në QKUK në Prishtinë.

I lartpërmenduri nuk e ka gjendjen ekonomiko sociale të mirë dhe nuk ka mundësi familja me i bartë të gjitha shpenzimet e transportit për dërgimin e tij për në Prishtinë për marrjen e terapisë. Shefi i autoparkut do të pajisë të përmendurin më vërtetim për furnizim me karburant nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, në pajtim me procedurat që vlejné edhe për automjetet zyrtare. Drejtoria për Shëndetësi, do të kujdeset që të bëhet furnizimi i automjetit me karburant dhe do të përcjellë realizimin e këtij Vendimi.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar dhe kundër tij nuk është e lejuar ankesa. Pala e pakënaqur mund të hapi konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Administratës në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: z.Shemsedin Berisha, Drejtoria për Shëndetësi, Shefi i autoparkut dhe një kopje mbetet në arkivin e Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqese e Sektorit Ligjor
 Zekije Sutaj



Kryetari i Komunës
 Ilir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠHTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br.01-308/023	Data: Datum: 03.04.2023	

Kryetari i Komunës bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008), në nenin 59 paragrafi 1 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.18/2011), shqyrtoj kërkesën e datës 03.04.2023 të Prokurimit për themelimin e Komisionit vlerësues të tenderit: “Shërbime profesionale për të rritur dhe fëmije me nevoja të veçanta-fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar përmes qasjes multidisiplinar”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-1946-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-010-221, nxjerr:

V E N D I M

1.THEMELOHET: Komisioni vlerësues i tenderit: “Shërbime profesionale për të rritur dhe fëmije me nevoja të veçanta-fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar përmes qasjes multidisiplinar”, me numër të jashtëm prokurimi 633-023-1946-2-2-1 dhe numër të brendshëm prokurimi 633-023-010-221 dhe në komision caktohen:

- 1.1 Naim Sadriu,** Zyrtar për Standarde, Monitorim dhe Vlerësim, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Hasan Blakaj,** Drejtor në SHFMU “Bajram Curri” në Istog, anëtar dhe
- 1.3. Mimoza Kabashi,** Drejtoresh në SHFMU “Martin Camaj” Gurrakoc, anëtare.

2. Komisioni i cekur me lartë, ka për obligim që të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave konkurruese në pajtim me kriteret e specifikuara në dosjen e tenderit: “Shërbime profesionale për të rritur dhe fëmije me nevoja të veçanta-fuqizimi i personave me aftësi të kufizuar përmes qasjes multidisiplinar” me qëllim të konstatimit të tenderit të vlerësuar si me i miri, si dhe do t’i kryejë të gjitha punët dhe përgjegjësit tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni.

3. Të gjithë anëtarët e komisionit i nënshtrohen rreptësishtë dispozitave të nenit 11 të LPP-së në lidhje me mbrojtjen e informatave sekrete të ofertave.

4. Zyrtari përgjegjës i prokurimit do të organizoj, këshilloj dhe drejtoj punën e Komisionit vlerësues dhe do të siguroj respektimin e dispozitave të LPP-së si dhe përgjegjësin për vlerësimin e ofertave për projektin e lartcekur e merr Komisioni.

5. Obligohen anëtarët e komisionit që në afatin me të shkurtër kohor të prezantojnë pranë zyrës se Prokurimit dhe Prokurimi t’iu ofroj qasje në ofertave që kanë shprehur konkurrencë.

6. Ky Vendim hynë në fuqi menjëherë dhe për realizimin e tij do të kujdesen: Komisioni dhe Prokurimi.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit,
- Prokurimit,
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj.Zekije SUTAJ



Kryetari i Komunës
z.Illir FERATI



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	01 Nr. Br.305 /2023	Data: Datum: 03.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 pika b). të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 46, 47 dhe 48 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Nr.05/L-031 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.20/2016), nenin 68.1 pika 2 të Statutit të Komunës 01 Nr.62/10 dhe nenin 1 të Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve Nr.1/2014. Komisioni për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare, shqyrtoi kërkesën 06 Nr.553-10704 të datës 15.03.2023, të parashtruar nga Ramë Shatri nga Istogu dhe i propozon Kryetarit për ofrim të ndihmës financiare për shërim, të nxjerr:

V E N D I M

- 1. MIRATOHET:** kërkesa 06 Nr.553-10704 e datës 15.03.2023, e parashtruesit Ramë Shatri, për ofrim të ndihmës financiare për blerjen e terapisë për shërim dhe me propozimin e Komisionit i ndahen mjete financiare në shumë prej **300.00 € (treqind euro)**, nga programi buxhetor i Drejtorisë për Shëndetësi, kategoria ekonomike subvencione e transfere, si ndihmë momentale për shërim.
- Mjetet e cekura në pikën 1 të këtij Vendimi do të transferohen në xhirollogarinë e Ramë Shatri, në pajtim me procedurat e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe të Përgjegjësi.
- Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset: Drejtoria për Shëndetësi.
- Vendimi është përfundimtar.

A r s y e t i m

Ramë Shatri, ka parashtruar kërkesën 06 Nr.553-10704, me datë 15.03.2023, me të cilën ka kërkuar t'i ndahen mjete financiare për blerjen e terapisë për shërim.

Kryetari shqyrtoi propozimin e komisionit për vlerësim dhe shqyrtim të kërkesave shëndetësore për përkrahje financiare dhe të njëjtën e konsideron të arsyeshme dhe e miraton.

Nga shkresat e parashtruara dhe raportet e mjekëve shihet së Rama është i sëmurë dhe ka nevojë për blerjen e terapisë për shërim, e cila është mjaftë e kushtueshme.

I përmenduri është në gjendje jo të mirë ekonomike dhe nuk ka asnjë burim të rregullt të të ardhurave, kjo i pamundëson që me mjete vetanke të bëjë blerjen e barnave të nevojshme për shërim dhe në mungesë të mjeteve financiare përkrahet vetëm në shumë prej **300.00 € (treqind euro)**.

Në plan programin buxhetor të Drejtorisë për Shëndetësi është përcaktuar edhe pozicioni subvencione dhe transfere, mjete nga i cili pozicion sipas mundësive buxhetore shfrytëzohen për përkrahje dhe ndihmë individëve si ndihmë momentale për shërim.

Mjetet e përcaktuara në këtë vendim do t'i transferohen në xhirollogarinë e Ramë Shatri, në pajtim me procedurat aktuale që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Financave Publike.

Për sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KËSHILLA JURIDIKE: Ky vendim është përfundimtar. Pala e pakënaqur mund të hap konfliktin administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Administratës, brenda afatit prej 30 ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Ramë Shatri,
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor

Zekije Sutaj




 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-304/023	Data: Datum: 03.04.2023	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), në nenin 79 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.8/2019) dhe bazuar në nenin 15 të Rregullores (QRK) Nr.05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës, shqyrtoi kërkesën me 02Nr.16/2023 të datës 27.03.2023 të parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimi për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, nxjerr:

V E N D I M

1.MIRATOHET: kërkesa 02Nr.16/2023 e datës 27.03.2023, e parashtruar nga Menaxheri i Personelit për themelimin e Komisionit të pranimi për zhvillimin e procedurave të rekrutimit pranim-Kuzhinier/e sipas konkursit 02Nr.37/23 të publikuar me datën 03.03.2023 në kuadër të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale dhe Komisioni i pranimi themelohet me këtë përbërje si me poshtë:

- 1.1. Shefqet Shatri,** Infermier në shtëpinë e të moshuarve (komunitetit) në Gurakoc, Kryesues i Komisionit;
- 1.2. Verdita Bajraktari,** Infermiere në shtëpinë e të moshuarve (komunitetit) në Gurakoc, anëtare;
- 1.3. Zize Bujupaj,** E emëruar Menaxhere e Personelit, anëtare;

3. Punët e Komisioni të lartcekur janë të përcaktuara me Ligjin Nr. 06/L -114 për Zyrtarët Publikë dhe me Rregulloren (QRK) Nr.05/2022 për procedurat konkurruese dhe pranimi për nëpunësit administrativ dhe mbështetës.

4. Të gjitha punët tekniko-administrative për nevoja të komisionit do ti kryejë Zyra e Personelit.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit dhe për zbatimin e tij do të kujdeset: Komisioni.

6. Vendimi është përfundimtar.

Vendimi i dërgohet:

- Komisionit të pranimi;
- Zyrës Personelit dhe
- Arkivi i Zyrës së Kryetarit.

Udhëheqëse e Sektorit Ligjor
znj. Zekije SUTAJ


